

VENDIM

Nr. 43 , datë 24/12/2020

MBI

**“MIRATIM PËR RINOVIMIN E KONTRATËS SË QIRASË NDËRMJET
UNIVERSITETIT TË ARTEVE DHE SHOQËRISË CORNER SH.P.K.”**

Në zbatim të ligjit nr.80/2015,datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 39 (Funksionet dhe kompetencat e Rektorit të Universitetit të Arteve), VKM nr.54, datë 5.2.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth Relacionin e Sektorit Juridik për vijueshmerinë e rinovimit të kontratës, paraqitur nga Administratori i UART Znj. Alma Sinanaj, pasi e diskutoi, me votim thapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rinovimit të Kontratës me objekt, dhënie me qira të sipërfaqes prej 139 m², (*mjedis në këndin jugor të Universitetit të Arteve*), për a) sipërfaqe ndërtimi e brendshme: 90 m² dhe b) sipërfaqe funksionale: 49 m², midis Universitetit të Arteve dhe shoqërisë Corner sh.p.k;
2. Kontrata lidhet me afat kohor 1 vjeçar (12 muaj). Kur kushtet janë të njëjta dhe nuk kemi nga asnjëra palë kërkesa për ndërprerje të njëanëshme, rinovohet automatikisht kontrata për një periudhë njëvjeçare/12 mujore;
3. Bashkëlidhur vendimit Kontrata e Qirasë;
4. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Administratori i Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike Inv/Prok/Bl..
6. Vendimi të publikohet në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Risena Xhaja (Kryetar)

Prof. Besnik Bisha (Anëtar)

Prof. Arben Basha (Anëtar)

Aida Martiro (Anëtar)

Prof. Bujar Kapexhiu (Anëtar)

Lorenc Vangjeli (Anëtar)

Vladimir Llakaj (Anëtar)